



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë 13/06/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë

Për: Operatorin ekonomik **Bolv Oil sha NIPT K32528408H**

Adresa: Grizë, Patos, Fier, ZK-2890, Nr.Pas.68/3.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-66313-04-30-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë e hapur me objekt “Blerje karburant diesel për ngrohje 0.1%”, kohëzgjatja e kontratës deri 15.03.2019 nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: **49 387 735** (dyzet e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) **Lekë pa tvsh.**

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 31.05.2018

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **Bolv Oil sha** me **NIPT K32528408H** me seli në Adresë: Grizë, Patos, Fier, ZK-2890, Nr.Pas.68/3, me ofertë: **23.8 %** (njëzet e tre pikë tetë përqind marzhi i fitimit).
2. Operatori ekonomik **“A&T” Sh.a** me **NIPT L32320008H** me seli ne adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower”, Kati.7, Ap.3, Tiranë me ofertë ekonomike **28%** (njëzet e tetë përqind marzhi i fitimit).
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“EROIL” sh.a** me **NIPT L32230076S** dhe **DAS OIL shpk** me **NIPT L52230020G** me seli ne Adresa: 1.Rr.Pjetër Bogdani”, Pall.23/1, kati.6, Ap.24, Tiranë, 2.Rr.Pjetër Bogdani”, Pall., Ap.15, Tiranë me ofertë **9.4%** (nëntë pikë katër përqind marzhi i fitimit).
4. Operatori ekonomik **RESULI-ER Sh.a** me **NIPT L12510413V** me seli ne adresa: Rruga “Baltes”, Qendër Daullas, Fier nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1) Operatori ekonomik **“A&T” Sh.a** me NIPT **L32320008H** me seli ne adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Kulla “Sky Tower”, Kati.7, Ap.3, Tiranë me ofertë ekonomike 28 % (njëzet e tetë përqind marzhi i fitimit), përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - Ka mangësi të theksuar dokumentacioni pasi nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas kërkesave të DST.
- 2) Bashkimi i operatorëve ekonomikë **“EROIL” sh.a me NIPT L32230076S dhe DAS OIL shpk me NIPT L52230020G** me seli ne Adresa: 1.Rr.Pjetër Bogdani”, Pall.23/1, kati.6, Ap.24, Tiranë, 2.Rr.Pjetër Bogdani”, Pall., Ap.15, Tiranë me ofertë 9.4% (nëntë pikë katër përqind marzhi i fitimit), përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues të plotë por vetëm pjesor për likuidimin e taksave vendore të vitit 2018 për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin për operatorin ekonomik Das Oil shpk.
 - Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion vërtetues për likuidimin e taksave vendore të vitit 2018 në vendet ku ushtron aktivitetin për operatorin ekonomik Eroil sha.
 - Dokumentacioni i autoboteve për autobotet është paraqitur i paplotë dhe një pjesë e tij është paraqitur në fotokopje dhe jo origjinal ose i noterizuar.
 - Eroil sha e ka paraqitur lejen mjedisore në fotokopje dhe jo origjinal ose i noterizuar.
- 3) Operatori ekonomik **RESULI-ER Sh.a me NIPT L12510413V** me seli ne adresa: Rruga “Baltes”, Qendër Daullas, Fier, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokumentacion tjetër sipas kërkesave të DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se, oferta e Operatorit Ekonomik **Bolv Oil sha me NIPT K32528408H**, përmban dokumentacionin e kërkuar referuar listës së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit/kualifikimit në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914 date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik“, të cilat janë të detajuara në dokumentat standarte te tenderit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66 pika 4, Komisioni konstatoi se, oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” si dhe kriterëve te pranimit/kualifikimit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **Bolv Oil sha me NIPT K32528408H** është në përputhje me kërkesat e pranimit/kualifikimit, duke e shpallur ofertë të vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **Bolv Oil sha me NIPT K32528408H** me seli ne Adresa: Grizë, Patos, Fier, ZK-2890, Nr.Pas.68/3, se oferta me vlerë **23.8 %** (njëzet e tre pikë tetë përqind marzhi i fitimit), e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje karburant diesel për ngrohje 0.1%”**, me afat të lëvrimit deri **15.03.2019** nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05/06/2018

Ankesa: S`ka pasur

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Feti Fanaj

